

---

**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT  
“GEOHAZARDS CONSULTING” sh.p.k**

**KAPITULLI I  
EMRI I SHOQËRISË- SELIA- KOHËZGJATJA-OBJEKTI**

Neni 1  
**Emri**

- 1.1. Shoqëria do të quhet GEOHAZARDS CONSULTING shpk. (Këtu e më poshtë “Shoqëria”)
- 1.2. Shoqëria do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjësi të kufizuar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- 1.3. Shoqëria ka logon dhe vullën e saj zyrtare.

Neni 2  
**Selia**

- 1.1. Selia e shoqërisë do të jetë tek rruga “Arkitekt Kasemi”, ndërtesa nr. 240/1, Shkalla nr. 3, Tiranë, Shqipëri.

Neni 3  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e palimituar.

Neni 4  
**Objekti**

- 4.1. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është:

- Kërkim shkencor dhe inovacion në fushën e gjeologjisë-inxhinierike, sismologjisë, hidrogjologjisë, gjeologjisë, topografisë dhe mjedisit.
- Studim/Vlerësim Gjeologo-Inxhinierik (Kategoria 9 në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim): Studim/Vlerësim Gjeologo-Inxhinierik i trojeve për: a) objekte civile-ekonomike deri 5 kate, b) objekte civile-ekonomike mbi 5 kate, c) objekte të mëdha H/Ç, porte, aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha, ç) troje të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët. d) Studime dhe projekte hidrogjeologjike.
- Studime të Sizmologjisë Inxhinierike (Kategoria 12 në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim): Studime/vlerësimi të sismologjisë inxhinierike për: a) klasifikimin gjeosizmik të trojeve, b) trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore, c) trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte, etj, ç) trojet ku ndërtohen objekte komplekse si:

hidrocentrale (për çdo fuqi të instaluar), termocentrale, porte, aeroporte, tunele për vepra hidroteknike, bazamente për ngarkesa të mëdha dhe objekte industriale, d) troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkrifëta me mundësi lëngëzimi. dh) Studime të rrezikut sizmik në nivel rajonal (mikrozonime sizmike) dhe në nivel kombëtar (hartat kombëtare të rrezikut sizmik).

- Studim/projektim Gjeodet (Kategoria 8 në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim): a) rilevime inxhinierike, b) rilevime inxhinierike kadastrale, c) sisteme GIS, ç) bazamente gjeodezike dhe d) projektim fotogrametrik dhe hartografik.
- Punime speciale ndërtimi (N.S- 20) Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë. Marrje kampionesh me cilësi të lartë (Q5). Zhvillimi i provave laboratorike dhe in-situ për përcaktimin e parametrave fizikë dhe mekanikë (sipas Eurokodeve dhe KTP) të dherave dhe shkëmbinjve.
- Rilevimi gjeologo – inxhinierik, gjeologjik, hidrogjeologjik dhe geomorfologjik në shkallë të ndryshme. Rilevimi gjeo-mekanik i masivëve shkëmbore dhe klasifikimi i tyre sipas kriterieve ndërkomëtare për vepra inxhinierike të mëdha rrugë, ura, H/C, diga, tunele, galeri, naftë/gazsjellës.
- Studimi/Vleresimi i Risqeve gjeologjike (tërmetet, lëvizjet shpatore, erozioni, përmbytjet) dhe i fenomeneve gjeologjike të lidhura me to (lëngëzimi, amplifikimi sizmik, adensimi etj.). Monitorimi i shpateve dhe projektimi i masave mbrojtëse.
- Përdorim i paisjeve të sofistikuara për monitorimin dhe kontrollimin (pa dëmtuar) veprave inxhinierike civile dhe industriale. Studime/vlerësimë të vulnerabilitetit sizmik të objekteve.
- Studimin/Rilevimin e objekteve inxhinierike (godina, ura, H/C, diga, tunele, galeri, naftë/gazsjellës), monumenteve kulturore dhe monumenteve arkeologjike nëpërmjet teknikave të “Remote Sensing”.
- Ndërtimi i databasa-ve në GIS, përpunimi dhe dixhitalizimi i hartave të tipeve dhe shkallëve të ndryshme. Programim në QGIS.
- Studime/vlerësimë gjeomjedisore: a) hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, b) kryerjen e auditimit mjedisor dhe c) hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore. Konsulenca si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe/ose rezultatet e një auditimi.

## KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR

### NENI 5 Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 30.000 lekë (tridhjetë mijë lekë) i përbërë nga 1 kuotë. **Kapitali i shoqërisë përbehet nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 30.000 lekë (tridhjetë mijë lekë).**

1. Z. Klodian Skrame zotëron 100 % të kapitalit të shoqërisë ne vlerë 30.000 lekë (tridhjetë mijë lekë).

Kapitali mund të shtohet ose të pakësohet. Kuota në kapital janë të gjitha të emruara dhe të pa ndashme. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

#### **NENI 6**

Kapitali i shoqërisë përbëhet, nga kapitali fillestar plus shtesën e bërë, mjetet e xhiros, pasuri të luajtshme ose të paluajtshme etj. të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

#### **NENI 7**

Kuotat e kapitalit janë të pasqyruara dhe të regjistruara në librat e llogarisë së shoqërisë.

#### **NENI 8**

Heqja dore e ortakut nga bashkëpunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet që kanë lindur para se ai të largohet. Po kështu ai fiton dhe të drejtat që janë krijuar para largimit të tij.

#### **NENI 9**

Fitimet që realizohen gjatë veprimtarisë dhe që konkretizohen më nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakëve në proporcion me përqindjen e kapitalit të investuar, por kurdoherë pasi të janë shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga ortaket nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar në ligj.

#### **NENI 10**

Shoqëria tregtare “GEOHAZARDS CONSULTING” sh.p.k. është përdoruese dhe disponuese e pasurisë se saj. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, material ose jo material, duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurive të veta tek të tjerët.

Në Republikën e Shqipërisë Shoqëria tregtare “GEOHAZARDS CONSULTING” sh.p.k. gëzon të drejta sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj në përputhje me legjislacioni në fuqi.

#### **NENI 11**

Shoqëria tregtare “GEOHAZARDS CONSULTING” sh.p.k. vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejtat e detyrimet vetëm brënda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët themelues të shoqërisë, mbartin rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kuotave të kapitalit të investuar në të. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet që ortakët kanë pasur para se ajo të krijohet.

**KAPITULLI III**  
**DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

**NENI 12**  
**Kompetencat e ortakut**

- 13.1** Ka të drejtë të administroj aktivitetin e shoqërisë, konform objektit të veprimtarisë së saj, duke përfshirë edhe veprimtarinë prodhuese e tregtuese që Shoqëria mund te kryej, vlerat e saj intelektuale e ekonomike-financiare. Kane të drejtë të marrin dijeni për rezultatet ekonomiko financiare në çdo fazë te aktivitetit te saj. Kanë të drejtë të marrin pjesë vetë ose me anë të përfaqësuesëve në ketë aktivitet.
- 13.2** Kanë të drejtë të térheqin të gjitha dokumentet kryesore të shoqërisë për tre vjetet e fundit.
- 13.3** Kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe mund të shesin pjesën e kapitalit të tyre në përputhje me kushtet që i lejon statuti dhe ligji.
- 13.4** Ortaket në përputhje me statutin e aktin e themelimit dhe legjisacionin në fuqi kanë, të drejtë që në të njëjtën kohë të jenë ortakë edhe në shoqeri të tjera.
- 13.5** Ortaket rezervojnë të gjitha të drejtat sipas ligjit Tregtar.

**NENI 13**

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj Z. Klodian Skrame nga data 11.05.2023-10.05.2028

**NENI 14**  
**Administrimi i shoqërisë**

- 15.1** Administratori ka të gjitha të drejtat dhe fuqitë për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë, me qëllim që të arrijë objektivat e saj, përveç atyre që ligji ia atribuon ortakëve.
- 15.2** Administratori përfaqëson shoqërinë në mardhënie me të tretët si dhe para organeve të administratës dhe atyre gjyqësore.
- 15.3** Administratori emerohet dhe shkarkohen me vendim të ortakëve, ka të drejtë të veproj, firmosi pranë çdo organi administrativ, banke të nivelit të dytë dhe ku të shikohet e arsyeshme për të ushtruar aktivitetin e shoqërisë.
- 15.4** Shoqeria administratohet nga të paktën 1 (një) dhe maksimumi 2 (dy) administrator, të cilët qëndrojnë në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh.
- 15.5** Çdo administrator do të ketë të drejtë për rimbursimin e shpenzimeve të bëra prej tij për llogari të shoqërisë.
- 15.6** Kur administrator i shoqërisë rezulton i sukseshem në punën e tij dhe në rezultatin financier të kompanisë atëherë ortakët vendosin lidhur me shpërbllimin qe do ti jepet atij në fund të vitit finanziar.

## **NENI 15** **Detyrat e Administratorit/ëve**

Administratori i shoqërisë ka dhe këto detyra dhe të drejta.

- Të mirë administrojë pasurinë e shoqërisë;
- Të lidhë marveshje me të tretët brënda objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe kompetencave të caktuara nga ortakët;
- Të zbatojë rregullat e brëndëshme të shoqërisë;
- Të shpërblejë dëmet që i vijnë shoqërisë si pasojë e veprimeve apo mos veprimeve të tij;
- Të paguhet për punën e kryer në bazë të marveshjes së bërë midis tij dhe ortakëve;
- Të marrë të dhëna e të bëjë propozime mbi gjithçka që ai e quan të dobishme për shoqërinë;
- Të mirtojë planet e llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre dhe ti paraqese ato sipas rastit për miratimin përfundimtar nga ortaket;
- Të bëhen propozimet përkatëse ortakut të vetëm kur lind nevoja për ndryshime në kapitalin themeltar të shoqërisë;
- Të miratojë aktet normative që përcaktojnë raportet në gjirin e shoqërisë duke përfshirë kuadrin e personelin;
- Të përcaktojë strukturën e aparatit të shoqërisë dhe të krijojnë organe të tjera të domozdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë;
- Ti propozojë ortakëve për krijimin e njësive strukturave të ndryshme si filial, degë e përfaqësi në qytetet e tjera të vendit ose jashtë shtetit;
- Të përgatisë propozimin për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe t'ia paraqesë ortakut për miratim. Të përzgjedhë ekspertin kontabël dhe anëtarë të komisionit të likuidimit si dhe të paraqes propozimet për miratim para ortakëve;
- Të sigurojë zbatimin e përpiktë të Vendimeve të Ortakëve;
- Të kryejë çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga ortaku i vetëm i shoqërisë.

## **NENI 16** **Audituesi Ligjor**

- 17.1** Shoqëria cakton Audituesi Ligjor për çdo viti finanziar. Caktimin e tyre e bënë administrator.
- 17.2** Audituesi Ligjor mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e rregullt të gjithë dokumentacionit të shoqërisë.
- 17.3** Ato përgjigjen për dëmet që i vijnë shoqërisë nga mbajtja e pa rregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.
- 17.4** Audituesi Ligjor mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
- 17.5** Nuk mund te ngarkohen me detyrën e Audituesi Ligjor, themeluesit, administratoret, personat qe janë në gjini e krushqi deri në shkallën e katërt. Po ashtu nuk mund te kryejenë këtë detyre per gjegjësat e zyrave, filialeve e agjensive.

**KREU III**  
**MARDHENIET E PUNES**

**NENI 17**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave të punës. Për çeshtjet që kjo kontratë nuk i parashikon zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

**NENI 18**

Për çdo mos marrëveshje që mund të lind midis palëve dhe që nuk zgjidhet me mirëkuptim apo konsensus, organi kompetent për zgjidhjen e saj është Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë.

**NENI 19**  
**Sekreti i punës**

Të gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë. Kjo detyrë vazhdon edhe pas largimit të tyre nga shoqëria.

**KAPITULLI IV**  
**VITIT FINANCIAR, BILANCI VJETOR SHPERNDARJA E FITIMIT**

**NENI 20**  
**Viti finanziar**

Vitit finanziar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

Përashtimisht Viti i pare finanziar përfshin kohën nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe përfundon më 31 dhjetor të një viti.

**NENI 21**  
**Inventari dhe llogaritë vjetore.**

Shoqëria do te mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkесat ligjore.

Në mbylljen e vitit finanziar administrator harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për vitin finanziar.

**NENI 22**  
**Raportet vjetore**

- 23.1** Në mbylljen e çdo viti finanziar administratori dhe eksperti kontabël harton inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për kontabilitetin si dhe harton një raport me shkrim për ortaket.
- 23.2** Raporti pasqyron gjëndjen e shoqërisë gjate vitit finanziar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e rëndësishme etj.

- 23.3** Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga ortakët sipas Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

**NENI 23**  
**Rezerva e domosdoshme dhe e nevojshme.**

- 24.1** Nga fitimi i realizuar gjatë vitit finanziar pasi zbriten humbjet e vitit te mëparshëm, hiqet më një anë një shumë e barabartë me 5 % (pesë përqind) të fitimit e destinuar për formimin e fondit rezervë të quajtur "rezervë e domosdoshme".
- 24.2** Heqja nga fitimi për rezervën e domosdoshme pushon së qëni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 10 % të kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur për një arsyesh çfarëdo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nën 10% e kapitalit.
- 24.3** Ortakët mund të vendosin edhe zbritje të veçantë në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo për shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

**NENI 24**

Të ardhurat eventualisht të ndjekura nga shoqëria çdo vit finanziar janë të destinuara siç është vendosur nga ortakët duke i qëndruar në uljen 5 % që do ti destinohet rezervës ligjore.

**KAPITULLI V**  
**MBYLLJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI**

**NENI 25**

Veprimtaria e shoqërisë mund te ndërpritet para afatit kur shoqëria nuk rezulton rentable gjatë dy vjetëve të fundit radhazi dhe kur për ketë vendos gjykata kompetente.

**NENI 26**

- 27.1** Menjëherë pas marrjes së vendimit për prishjen e shoqërisë, ortaket caktojnë një likuiditor, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, me dispozitat përkatëse të ligjit tregtar. Shoqëria gjate likuidimit mban anash emërtimit dhe emrin "Shoqëri në Likuidim e sipër".
- 27.2** Likuiditori i emëruar nga ortaket menjëherë sa po merr detyrën është i detyruar të publikojë bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'i vëre në dispozicion menjëherë ortakëve.
- 27.3** Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

## **NENI 27**

Ortakët vendosin mbi rregullshmërinë e likujdimit, për të vendosur për bilancin e likujdimit dhe heqjen e mandatit të likuiditorit.

Ortakët mund të vendosin vetë realizimin e kesaj mbledhje, në rast se likuiditori nuk e kërkon. Mbledhja vendoset edhe nga gjykata mbi propozimin e Ortakëve ose të një mandatmbajtesi të caktuar prej tij.

## **NENI 28**

Kur ortaket për shkaqe të arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata mbylljen e likuidimit.

Aktet e mbylljes dhe likuidimit e depozitimit të dokumentacionit në regjistrin tregtar Shoqeria ç'registrohet prej tij.

## **DISPOZITET KALIMTARE**

### **NENI 29 Dispozitat e fundit**

- 30.1** Për të gjitha cështjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozita e Ligjit Nr 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
- 30.2** Për efekt të inteprentimit të këtij Statuti me Ligj Tregtar nënkuftohet Ligji nr 9901 datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare"
- 30.3** Pavlefshmëria eventuale të dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të cenojnë vlefshmërinë e tij.

### **NENI 30 Gjykata kompetente.**

Gjykata kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarveshjeve dhe intepretimin e Statutit të Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

### **NENI 31 Hyrja në fuqi**

Ky Statut dhe Akt themelimi hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e firmosjes.

**THEMELUES I SHOQËRISË  
“GEOHAZARDS CONSULTING“ sh.p.k.**

**Z. Klodian Skrame**

Tiranë më 11/05/2023

